


GURAS

REVISTË E NXËNËSVE TË GJIMNAZIT “CAMBRIDGE” Nr.10



*Po le shkollen pas dore...
Koha të sfidon orë pas ore*



Fjala e drejtorit

Guras

Gjimnazi "Cambridge"

Revista Nr. 10

www.gjimnazicambridge.com
schoolpeje@gmail.com
+38649554500
+38139432450

Këshilli redaktues:
Aktivi profesional i shkollës

Bashkëpunëtorë

Nxënësit e gjimnazit
"Cambridge"

Përgaditja për shtyp
dhe dizajn
Florim Beqaj

Shtypi
Dukagjini
Pejë, 2018



Prof. Dr. Jakup Beqaj

Fjala e drejtorit

Shkolla e jonë Gjimnazi "CAMBRIDGE", më shumë se dy dekada punë e palodhshme, duke edukuar breza të rinjë!

Ky institucion privat vatër e dijes dhe e suksesit të vazhdueshëm nisi si një filizë e re në Dukagjin, u rrit dhe u zhvillua si tempull i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i dijes.

Filluam me shkollë të gjuhëve të huaja "THE CAMBRIDGE SCHOOL" dhe e vazduam me hapjen e GJIMNAZIT "CAMBRIDGE". E zgjeruam në këtë mënyrë sepse arsyja kryesore ishte kërkesa për themelimin e një burimi të dijes, gjimnaz në nivelin më të lartë dhe bashkëkohor, edukativo-arsimor.

Gjith ky sukses është falë udhëheqjes së drejtë në suaza të barabarta për secilin, duke filluar nga stafi i mësimdhënësve ashtu edhe grapi administrativ e punues i shkollës të cilët bëjnë një punë të palodhshme e të cilësisë së lartë. Pra, bashkëpunimi interaktiv mësimdhënës-nxënës-prindër janë këto etapa pune që të gjitha rezultojnë me suksesin tonë që ne sot po ekzistojmë si shkollë unike me vlerat e saja të veçanta.

Atëherë, gjithë ky rrugëtim reflekton me shembujt që na shfaqen nëpër institucionet dhe vende të ndryshme pune. Ku ish nxënësit e GJIMNAZIT "CAMBRIDGE" sot janë krenaria e institucionit ku ndodhen.

I tërë ky sukses është rrjetohojë e edukimit dhe formimit cilësor që morën në këtë insitucion.

Ashtu si vet emri "GURAS" që mbanë revista, shkolla jonë është një vatër që ekziston, reziston dhe kurrë nuk ka qetësinë e saj në edukim, zbulimin dhe formimin e talenteve të rinjë.

Jemi bashkëudhëtarë në brumosjen dhe zhvillimin e nxënësve për çdo brez të ri.

G u r a s

Me të vegjlit e shkollës

KLASA PËRGATITORE

Nxënësit e programit parafillor të shkollës sonë janë filizat me te njoma të cilët me punën e palodhshme të mësueses dhe bashkëpunimit të prindërve çdo ditë e më shumë mësuan dhe përparuan në zhvillimin kognitiv në formë të aktivitetit rekreativo-mësimor.

Filluan nga njoftimi me ambientin e shkollës dhe posaquerisht me klasën e tyre vendin shumë të dashur.Kështu që veprim pas veprimi ata ecen në rrugën e dijes , qoftë me anë të lojës edhe në formë të dëgjuarit nga mësuesja , dhe duke vizatuar, pra imaginata e tyre e vogel e shfaqur në letër. Mirëpo të vegjilit e shkollës sonë mësuan edhe në gjuhën angleze, duke filluar nga prezantimi e tyre thënë ndryshe preken të gjitha segmentet për nivelin që janë.



U mësuam të jemi pjesë e skenës,për festën e 28-Nëntorit-Ditës së Flamurit Kombëtar , kënduam këngë. Zërat tonë të njomë i dhanë madhështi skenës !

G u r a s

Me të vegjlit e shkollës

KOMUNIKIMI DIKUR



Atë që e mësuam e vendosëm të vizatuar në murin e klasës ,tani ne mësuam komunikimin me anë letrës Vendosëm në klasë edhe kutinë postare, ne dijmë edhe për mënyrën e komunikimit sot dhe dikur...

KËNDI I SHKENCËS



Filluam me lojë dhe mbaruam me një mësim të ri .Symbyllur ne dallonim gjërat,kuptuam nga mësuesja e jonë e dashur që lojen dhe mësimin i bëjmë me anë të shqisave.Gjithqka e re po vjen tek ne çdo ditë e më shumë...

LOJËRA MATEMATIKORE

U njoftuam edhe me numrat, për mes lojës ne prekim numrat që i dijmë..



G u r a s

Prezantimi i klasëve



Klasa Parë "Klasa Dielli"

Dielli vjen në agim,
Leshon rreze mbi ne.
Hap zemrat me gëzim,
Të mësojmë pa përtim.
Te mësojmë, të mësojmë
Vendin tonë ta ndriçojmë



Edhe këtë vit shkolla vazhdon rrugën drejt dijës me nxënës nga klasa e parë të quajtur "Klasa Dielli" që janë gjithsej 20 nxënës. Ishte një sfidë për ta ku ata nga ambient I ngrohtë familjar u përballen me një ambient të ri jo shumë të njojur përtat. Panë se secili shkoë e shoqë kishte nga një karakteristikë të vecantë, menjëherë filluan ta duan njëri tjetrin si të ishin motra e vellezër. Tani u bënë një klasë e cila dita ditës u ndërtua ne besim e rrespekt të ndërsjelltë.

Si risi mësimi zhvillohet per herë të

parë me kurrikulen e re te Kosovës dhe fatmirësisht u tregua mesimnxenie e plotë dhe nxënësit arritën suksese ne çdo fushë mësimore.

Prezantimi i klasëve

Luajmë duke mësuar, mësojmë duke luajtur

Puna u konkretizua edhe me shumë aktivitete, festa dhe lojëra ku nxënësit shpalosën shpirtin e tyre artistik, në role të ndryshme, me shumë kreativitet bënë punime të shumta dhe arritën titullin "Krijuesit e vegjël".



Pemë në pranverë, me beharë,
Pemë në verë, me nektarë,
Pemë në vjeshtë, me begati,
Pemë në dimër, për Vitin e Ri.

P-punë

E-edukim

M-motivim

A-arsimim

E gjitha e punuar me shumë dashuri, si diell të rrezojë për brezat e ri.

G u r a s

Prezantimi i klasëve

Shëndeti mbi të gjitha

Puna vazhdoj edhe në fushat tjera...

Ku u bë dhe integrimi I lëndëve dhe nxënësit u njohën me shëndetin dhe rëndësinë e tij.

Me duart e vogëla të tyre, bënë punime të shumta duke kuptuar sa më afër se:

“Shëndeti qëndron mbi të gjitha të mirat materiale, saqë një lypës I shëndetshëm është më I lumtur se një



Dita ditës bëjmë hapa drejt dipes me gojë plotë themi se jemi “Dielli rrezeartë”:

Guras

Prezantimi i klasëve

KLASA E DYTË



Nxënësit e klasës së dytë çdo ditë e më shumë po zhvillohen në të gjitha segmentet e dijes. Jo vetëm që nuk ndalën së punuari por ata dijnë të dëshmojnë edhe për punën që e bëjnë.

Erdhen si larva dhe tani janë fluturat më të bukura shumëngjyrëshe që çdo ditë e më shumë po fluturojnë lart. Me anë të aktivitetit dhe punës intenzive që bënë këtë vit shkollor u rritën si fizikisht ashtu edhe në aspektin edukativo-arsimor.



Prezantimi i klasëve

Për ne janë të bukura të gjitha stinët , por stinën e Pranverës e duam më së shumti! Andaj ne vizatuam në vizatimet tona dhe mbushëm fletoret me esetë më të bukura që shkruajtëm ne!



Prezantimi i klasëve

Ne jemi vërtetë të zellshëm dhe i përkushtohemi çdo aktiviteti që na jipet nga mësuesja e jonë e dashur.

Mësuam numrat, si t'i zbresim, por nuk pushuam së punuari, ne tanj dijmë edhe të rrisim edhe të zvogojmë problemet matematikore. Rrism duke shumëzuar dhe zbërthyer detyrat me anë të tabelës së shumëzimit. Kështu që fluturat




Shed em më punoja përfundimisht qëndrohet në një aktivitet që mund të bëhet edhe me fëmijët e shumtë. Në këtë aktivitet, fëmijët do t'ju prezantojnë rezultatet e tyre, mësuesi është përgjigjës.

Prezantimi i klasëve

KLASA E TRETË

“Mos harro të jeshë i kujdeshëm ndaj atyre që të duan dhe i do më së shumti”.

Nxënësit e klasës së tretë me shumë dashuri dhe përkushtim punuan kartolinat dhe shkruan fjalët më të embla për më të shtrenjtën, NËNË.



Vizitë Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nxënësit e shkollës sonë vizituan Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ata kishin mundësinë që të njiheshin për së afërm me hapësirën dhe mënyrën se si zhvillohen aktivitetet në kuvend.

Nxënësit ishin shumë kureshtarë dhe të emocionuar gjatë kësaj vizite, ku me ketë rast disa prej tyre morën rolet e udhëheqësve shtetëror. Ne urojmë që nxënësit tanë të jenë liderët e së ardhmës dhe të kontribuojnë për shtetin e Kosovës. 

Prezantimi i klasëve



Me ndihmën e profesoreshës së nderuar Hatixhe Ademaj, nxënësit e klasës së tretë, për here të parë u përballën me gjallesa të përmasave mikroskopike, dhe shuan kureshtjen e tyre se si marrin fryshtësimet!



Guras

Aktivitete të nxënësve



Vizitë me karakter mësimor në fabrikën e miellit M & Sillosi në Xérxë. Për nxënësit ishte rast i jashtëzakonshëm, ishin kureshtarë dhe nuk nguronin të bënин pyetje për të



Është sezioni i dytë që nxënësit vjelin të mbjellat e tyre. E mira e tërë kësaj pune është zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë dhe kujdesit tek nxënësit e klasës së tretë, qoftë edhe ndaj një fidane të mbjellur. Sa do të pakta që ishin frytet, ato kishin vlerë të paçmueshme për nxënësit. Krenaria dhe kënaqësia vështirë të fshehet nga fytyrat e tyre të ëmbla. Për sezonin e dimrit duhet të përgatitemi me kohë. Konservimi i perimeve çdoherë është detyrë e pritur me shumë entuziazëm. Mbi të gjitha mësojmë me kohë se: "Ne jemi çfarë hamë".

G u r a s

Aktivitete të nxënësve

KLASA E PESTË

Tani jemi në klasën e pestë dhe jemi më të fortë se asnjëherë.

Klaza jonë është dhoma e imagjinatës, shkencës, përallës, matematikës aty ku ne bëjmë punën tonë pa u lodhur dhe me shumë dashuri.

- Albisoni e don shumë natyrën dhe gjithmonë e ruan me shumë kujdes...
 - Kajani e don shumë shkencën dhe gjithmonë zbulon diçka të re...
 - Blerta e don shumë shkrimin dhe gjithmonë na mahnitë me thurjet e saj...
 - Ornela është shumë kreative, ajo zbukuron gjithmonë klasën tonë me punimet e saj të mrekullueshme...
 - Isa e don shumë drejtësinë , ai gjithmonë mëson për ligjet dhe luan rolin e pollicit të trafikut...
 - Rina e don shumë matematikën, ajo nuk do të ndalet deri sa ti fitoj garat...
- Ndërsa ne së bashku e duam mësuesën tonë e cila punon pa u lodhur që ne të shohim të ardhmen tonë më të mirë!

Disa nga aktivitetet tona si: vizita në Qendrën Burimore, "Xheladin Deda", në Pejë, vizita në Parlamentin e Kosovës, ekskursioni njëditor i organizuar nga shkolla, përgatitja eëmbëlsirave nga duart tona, eksperimente të ndryshme në kabinetin tonë të shkencës...



Guras

Aktivitete të nxënësve

Puna jonë është gjithmonë e pa lodhëshme dhe nuk ka kurrë të ndalur...



G u r a s

Aktivitete të nxënësve

EKSURSIONI NJË DITOR

Më datë 06.10.2017 u organizua një ekskursion një ditor që si qëllim kryesor kishte anën edukativo-arsimore e padyshim edhe rekreacionin për të shijuar bukuritë natyrore të zonave të veçanta të Kosovës.

Itinerari i ekskursionit ishte përcaktuar paraprakisht. E nisëm këtë rrugëtim për tu ndalur në vizitën e parë në Istog e duke vazhduar kështu tek Guri i Zi. Udhëtimi vazhdoi drejtë cakut të radhës. Pra, ishte ky Kopshti Zoologjik, kopshti i dashurisë për kafshët si personazhet dhe miqtë më të mirë të përrallave dhe fabulave të çdo fëmije. Pas këtyra vizitave të këndshme udhëtuam me kureshtje për befasinë e radhës. Nuk ka kuptim të realizosh një ekskursion e të mos e vizitosh qytetin e vjetër të Prizrenit, siç nuk ka kuptim ta vizitosh Prizrenin e mos ta vizitosh shtëpinë muze të "Lidhjes së Prizrenit". Qëllimi kryesor ishte njohja e nxënësve me historinë dhe ngjarjet e zhvilluara në atë vend, përkatësisht rëndësinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nxënësit patën rastin të informohen lidhur me historinë e vendit, sakrificat, mundin, gjakun e atdhetarëve dhe përballjen e tyre me shumë armiq. Pas Prizrenit, udhëtuam në Gjakovë ku nxënësit ishin të lirë të argëtoheshin me gjithçka që iu ofronte qyteti fëmijëve.

Meqenëse ky ekskursion i arriti objektivat e parapara, Gjimnazi Cambridge planifikoi ekskursionin e radhës edukativo-arsimor, e motoja ishte "Njohja me shtigjet e bardha".



Koment: Blerina Osmanaj



T'i quaj të veçanta momentet e përjetuara atë ditë!

Them kështu sepse u argëtuam pa masë dhe perjetuam kujtime të paharruara. Përveq momenteve të bukura, patëm rastin të zgjerojmë njohuritë e përgjithshme lidhur me kulturën e popullit, jetesën e kafshëve në kopshtin zoologjik si dhe traditat tona.

Guras

Gjimnazi "Cambridge"



Viti Shkollor 2017/18

Kujdestari



Drejtori



Prof. Mustafë Kadriqaj



Prof. Mustafë Kadriqaj



Edonis Abazi



Prof. Jakup Begaj



Bleon Zekaj

Rrezarta Nitaj



Taulanta Gashi

Zoje Lajqi



Blendi Tolai



Pajesha Dobroshi

Yllka Shoshi



Vlerri Begaj



Arjanit Ademaj



Megzon Hajdari



Leonit Cakaj



Arbios Jasiqi



Euron Shala



Altin Shurdhaj



Elsa Kelmendi

Gjimnazi "Cambridge"



Viti Shkollor 2017/18

Drejtori



Kujdestari

Prof.Jakup Begaj



Prof.Irena Ramosaj



Luan Imeraj



Lirik Studenica



Marigona Ukehaxhaj



Jetir Ukehaxhaj



Yll Kaligani



Mirlind Lokaj



Anis Byberi



Dijana Bozhdaraj



Leonita Bozhdaraj Jusaj



Merisa Tishukaj



Ardit Osmanollaj



Leotrim Jusaj



Prof.Irena Ramosaj

Aktivitete të nxënësve

FESTA “HALLOWEEN”

Në shkollën tonë tashmë nata e Halloween-it është bërë traditë e festimit për çdo vit. Me punën e pa lodhshme të grupit artistik dhe stafit të shkollës çdo kënd i shkollës frymoi festë, apo mori ngjyrë festë Halloween.



Koment: Vleri Beqaj



Për grupin artistik, çdo festë ka rëndësi të madhe, por do të doja ta veçoja në këtë rast festën më të dashur për ne, Halloween-in. Asnjë ekspozitë nuk është mbreslënëse pa artist të vërtetë, të cilët punojnë me plot shpirt, ashtu siç kemi zakon ne që me plot vullnet të shfaqim kreativitet tonë në ambientet e shkollës. Përveç tjerash, ne si artist të rinjë ndihemi krenar që me punën tonë arritëm që të vegjilit e shkollës ti gjëzojmë pa masë dhe tu ofrojmë hapsirën që ata meritojnë për ta festuar ketë ditë

G u r a s

Aktivitete të nxënësve

INICIATIVA HUMANITARE

Bamirësia nuk të varfëron!

Nxënësit tanë me humanitetin e tyre kontribuan sado pak në zbutjen e mundimeve të familjeve skamnore. Kush me veshmbathje, kush me ushqim e gjëra higjenike u bënë pjesë e kësaj fushate. Shërbimi ndaj njerëzve në nevojë është vepër e madhe!



Koment: Rinesa Çekaj



Shkolla jonë mori iniciativën për të dërguar disa ndihma në Kryqin e Kuq në mesin e nxënësve isha edhe unë që mora pjesë.

Për mua ishte një kënaqësi shumë e madhe që me ndihmën tonë sado të vogël gëzuam shumë njerëz.

Guras

Aktivitet festiv

FESTA E 28 NËNTORIT

Për nderë të festës së 28 Nëntorit, më datë 24.11.2017 Gjimnazi Cambridge organizoi një manifestim shkollor. Nxënësit tonë, të veshur me ngjyrat e flamurit kombëtar, dukeshin sikur të janë pjesë e tij dhe pritnin me padurim fillimin e manifestimit.

Sic e do tradita vetë nxënësit e udhëhoqën programin duke qenë vetë pjesëmarrës, moderues dhe ekzekutues të programit. Recitimet, vallet, këngët, ekspozita murale dhe në fund edhe sfilata me veshje kombëtare u përcollën me mjaft duartrokitje nga të pranishmit.

Festa vazhdoi në një ambient tjeter të shkollës, përkatësisht në sallën e Edukatës Fizike dhe Sportive ku u organizua turniri i futbollit me ndeshjet mes klasave. Për përgatitjen dhe mbarëvajtjen e këtij turniri u përkujdes profesori lëndës.

Pas një përballe shumë cilësore, fituese e këtij turniri doli klasa e IX-të.



Koment: Merisa Tishukaj



Falë sakrificave të mijëra luftëtarëve të cilët kanë rënë dëshmorë, ne jetojmë të lirë. Mburremi, nderohemi dhe mbi të gjitha ndjejshmë krenari që jemi pjesë e kësaj toke arbërore. Dhe këtë mburrje e kremitojmë me këngë e valle çdo vit.

Guras

Aktivitet festiv

FESTAT E FUNDVITIT

Muaji dhjetor, i cili njihet edhe si periudha më e bukur e vitit, motivoi nxënësit që me përkushtim të pasurojnë ekspozitën e murit me punime kreative dhe mbresëlënëse në gjuhën tonë dhe atë angleze. Grupi artistik, si çdo herë tjetër, dekoroi ambientet e shkollës duke na dhënë ngrohtësinë e festave të fundvitit.

Shkolla jonë përvèç se ofron mësimdhënienë të shkëlqyer, sigurisht që ofron mundësi të shumta argëtimi dhe hareje. Përndryshe ky muaj në shkollën tonë u shënua si "Muaji i festave të fundvitit, artit dhe kulturës".



Koment: *Eurolinda Gashi*



Çdo gjë frymon ndryshe këtë kohë, janë festat e preferuara të të gjithve!

Shkolla mori pamje festive, me shumë përkushtim i dekoruam ambientet e ndryshme dhe i dhamë atmosferën festive gjithë shkollës si edhe çdo vit tjetër...

Në këto hapësira frymojmë lirshëm, mësojmë shumë dhe po aq shumë argëtohem!

Guras

Ekskursion

SKIJIMI DIMEROR - “MAVROVA 2018”

Nxënësit e ciklit të lartë dhe ciklit të mesëm të ulët të shkollës sonë ishin në një ekskursion 5 ditorë në Mavrovë. Nën kujdesin e vazhdueshëm të profesorit të Edukatës Fizike, mësuan dhe praktikan stile të ndryshme të sportit të tyre më të dashur, skijimit. Ky udhëtim ishte sa frytdhënës po aq edhe argëtues për nxënësit tonë, të cilët përforcuan njohuritë etyre rrëth sporteve dimërore duke u aftësuar që të skijojnë të pavarrur.



Koment: Adea Shoshi



Ky ishte viti i dytë me radhë që unë i bashkohem ekskursionit të organizuar nga shkolla. Mund të them se është i domosdoshëm përjetimi i përvojave të reja e burimplota, përfshirë këtu aftësimin në sportin atraktiv të skijimit, mësimin e ndonjë gjuhe, ideje apo kulture të re, aktivitete këto që mundësohen me vizita të shpeshta si Mavrova dhe vende tjera që ofrojnë mundësi të tillë për nxënësit

Guras

Aktivitet festiv

MANIFESTIMI PËR 17 SHKURTIN NË AMBIENTET TONA

Pas një rrugëtimi të vështirë arritëm të përjetojmë kurorëzimin e Kosovës si shtet i pavarur. Nuk kishte si të mos i kushtonim rëndësi të veçantë një date kaq të rëndësishme të shënuar për popullin shqiptarë. Si çdo vit tjetër, edhe këtë herë Gjimnazi “Cambridge” organizoi një orë letrare për nderë të 17 Shkurtit. Një numër nxënësish e nderuan këtë ditë me krijimet e tyre të cilat vërtetuan madhështinë e kësaj festë. Krijuesit tonë të rinjë shpalosën aftësitë e tyre krijuese me anë të eseve dhe poezive të ndryshme.



Koment: Jona Morina



Ishte 17 Shkurti, dhe si çdo datë të tillë me vlerë, shkolla jonë e festoi. Nuk ishte një festë e madhe por mund të themi se ishte një orë letrare e shkëlqyer dhe ne ia kaluam shumë mire. E gjithë ora letrare ishte në fryshtë e asaj date. Poezitë dhe esetë e shkruara ishin mbresëlënëse, disa të përzgjedhura nga poetët më me vlerë të letërsisë sonë e disa të shkruara nga vet nxënësit, si puna ime që u paraqita me dy krijime personale. Për mendimin tim, eseja më e bukur ishte shkruar nga Filiza Ukaj ku tregoi për ngjarjen e nënës së saj që e përjetoi gjatë luftë... Shfaqja vazhdoi derisa përfunduan të gjitha leximet, pjesa më e bukur ishte ajo kur na duartrokisnin, brohorisnin dhe na përgëzonin për punën tonë të pandalur. Përmua ishte shfaqja më e bukur dhe dua ta përfundoj duke thënë se: “Nuk ka rëndësi se kush je, por se çfarë krijon”.

G u r a s

Opinionet e maturantëve



EKSPERIENCA IME NË GJIMNAZIN “CAMBRIDGE”

Sa hap e mbyll shtëpitë vitet kaluan. Ishte ekperiencë shumë e bukur të kaloj vitet më të rëndësishme të jetës në këtë shkollë. Me miliona kombinime, si kjo nuk do të gjel më. Është vendi ku shëron çdo plagë, është bërë shtëpia ime, njerëzit që i kam për rrith më janë bërë familja ime e dytë.

Kur erdha në këtë ambient isha shumë e vogël, nuk kisha shumë njohuri, por kjo shkollë më mësoj pothuajse përfundimtë gjithë jetës, jo vetëm që të jap dituri, por pas përfundimit ke një mendje të hapur dhe përvojë në të gjitha aspektet.

Jam mirënjoye ndaj prindërve që ma mundësuan një shkollim të tillë, ku në të ardhmen të kem një horizont të hapur përmundësi. Por mbi të gjitha nuk është fundi i një rrugëtimi përgjigje profesionale, por fillim i mbarë në pragun e zgjedhjeve të së ardhmes.

Pajtesa Dobroshi

SEKUENCA MË E BUKUR E ZHVILLIMIT TIM



“Ti ose tjetri, apo të dy”?!?

Jeta mund të rrëfehet si një vërtetim shkencor i mbushur nga segmente të ndryshme, të cilat ndikojnë në gdhëndjen individuale. Që këtë gdhëndje ta mbush me ngjyrime, në jetën time ndikoi GJIMNAZI “CAMBRIDGE”.

Shkenca pa art dhe arti pa shkencë janë dy elemente të fuqishme, por të humbura. Prandaj për herë të parë në gjimnazin “CAMBRIDGE” mësova që të bëj gërshtimin e “Mendjes dhe zemrës”. Këtu zhvillova aftësinë e menyrës së veprimit të botës reale në atë artistike që unë e quaj të brendshme.

Nuk përfundon e gjithë njohuria që mora këtu, mësova se shoqëria është njëri nga faktorët më të rëndësishëm përgjendjen emocionale të individit dhe individi e vetëkrijon shoqërinë e tij.

Vleri Beqaj

PSE ZGJODHA GJIMNAZIN “CAMBRIDGE” ?

Gjimnazi “Cambridge” është vendi ku unë inspirohem çdo ditë, vendi ku unë shohë një botë ndryshe, një botë plo



të dashuri dhe plotë entuziazëm. Pothuajse është bërë si shtëpia ime, ku unë mund të ndihem siç dua unë. Jam në vitin e fundi, por po të ishte e mundur, pa hezituar fare

G u r a s

Opinionet e maturantëve

KUJTIMET !



Vitet kalojnë shumë shpejt e bashkë me to edhe ne po rritemi e po bëhemë më të vetëdijesuar se që kemi qenë... Kur kam ardhur këtu në gjimnazin "Cambridge", isha një vajzë e vogël e cila nuk kishte shumë njohuri për gjërat që ndodhnin papritur, për rregullat e jetës, si duhet të sillemi që të bëhemë dikushi... të gjitha këto i mësova nga një profesorë i ndjerë, i cili ishte shumë i dashur për mua, ai jo vetëm që mbeti në zemrën time po do jetë edhe në mendjen e zemrën e të gjithë kolegëve të tij, nxënësve e të shumë personave që patën fatin ta takonin...

Nuk është me rëndësi se ku jemi, së bashku me shoqëri do krijojmë momente të paharueshme, e shumë mundësi na krijoj edhe gjimnazi "Cambridge", ku ndër to ia vlen të përmenden ekskurSIONET E NDRYSHME RRETH KOSOVËS, NË MAVROVË E NË SHQIPËRI, KU SË BASHKU ME PROFESORËT TANË, KALONIM DITË TË MREKULLUESHME. Rrugëtimi im në këtë shkollë do të mbetet gjithmonë në mendjen time, të gjithë i kemi ato momentet e këqija dhe ato të mirat, por kur i shkojmë më hollësishët këto të fundit do të kenë rolin kryesor. Këto 7 vite shkuan shumë shpejtë, por kjo shkollë, këta persona të dashur që gjenden këtu më janë bërë si një familje e dytë dhe sigurisht që do të jetë shumë e vështirë ndarja. Si mund t'i them lamtumirë këtij vendi që sa herë shikoj përreth, shoh veten time në çdo kënd, shoh kohërat e bukuria me shoqëri e sidomos njerëzit që më ndihmuani të jem kjo që jam tanë...

Për të gjitha këto mundësi, i vetmi falenderim shkon për prindërit e mi, që donin të më shihnin me kujdes se si rritesa dhe donin që unë të kem një të ardhme sa më të mirë. Epo, jeta nuk do të mbaroj këtu, në fakt tani do përfundoj vetëm një pjesë e saj, dhe që pas kësaj do të ketë sfi da të reja e të papritura, e ky akoma është vetëm fillimi.

Yllka Shoshi

ARSYEJA PSE JAM KËTU



Ëndërra e çdo prindi është që fëmija i tij të mësoj të vëtdijësohet për jetën, të ketë arritje Si çdo prind tjetër ashtu bënë edhe prindërit e mi.

Në klasën e tetë të shkollës fillore u regjistrova në Gjimnazin "CAMBRIDGE".

Për mua ishte një ndryshim i madh pasi që fillova të shoh botën me një sy tjetër, duke pasur një sy kritik kisha një hapësirë të gjërë për bashkëpunime, nga këtu fillova aventurat e mia si adoloshente.

Shkolla e jonë na mundësoi që të jem pjesë e pothuajse të gjitha aktivitatetave, organizimeve të cilat më bënë më të aftë për atë që synoi sot.

Taulanta Gashi

G u r a s

Këndi i poetëve

Libri



Thuhet se libri është miku më i mirë. E vërtetë!

Sa herë që na duhet një përgjigje e gjemë aty; Sa herë ndjehemi të vettuar na shoqëron duke na futur në botën e magjishme të artit, sa herë na humb motivimi libri na jep forcë e na bënë të vazhdojmë përpara. Libri është diell që nuk perëndon kurrë; është univers i pafund që na hap dyert e jetës.

Me 23 prill është dita ndërkombëtare e librit, por nuk mjafton vetëm një ditë në nderim të tij. Çdo ditë, çdo zgjim të ri, duhet tu jemi mirënjoës librave sepse ata bartin me shkuj përvojën e brezave; Ata janë arma më e fortë që na mbrojnë nga mbretëria e errësirës së paditurisë. Prandaj t'i jemi mirënjoës librit, rrezës që ndriçon vazhdueshëm rrugën e jetës sonë.

Dribardha Krasniqi

Kush jam unë



Jam filiza e kapitullit në mes të kapitujve të vjetër.
Ku fillimi është fund e fundi fillim,
Jam xixa e strallit në mes të kapitullit të kaluar.
Hej bre....,jam shkëndija në mes të shiut,

Jam e fortë në lidhje me brishtësinë.
I qëndrueshëm brenda paqendrueshmërisë,
E depërtuar brenda zymtësisë.
E ngrohtë brenda ngurtësisë.

Marigona Ukëhaxhaj

Vlera e arsimit



Në Kosovë arsimi nuk po zhvillohet në kushtet më ideale , por fat-mirësish ka ende shkolla dhe mësues ku janë në gjendje që të sakrifikojnë shumë për shkollimin e nxënësve. E përmendimin tim njera prej këtyre vendeve është shkolla jonë.

"GJIMNAZI CAMBRIDGE", ku të gjithë punën e tyre e kryejnë me përpikëmëri. Shkolla e jonë shfaqë shembuj të sukseseve në fusha të ndryshme si: Disiplinë, pergatitje shkencore etj.

Arsimi iuan rol të rëndësishëm në jetën e njeriut .Synim kryesor është arritura e zhvillimit etik , intelektual,fizikë, social dhe estetik të nxë nësit , në mënyrë të pavarur kritike e krijuese,t'u pershatat ndryshimeve , të ketë vetbesim e shpirt bashkëpunimi dhe të jetë i gatshëm të ofroj përpjekjet e tij përmirëqenje,perparim e liri.Për të gjitha keto arsyet unë vendosa që arsimin ta vazhdojë në ketë shkollë, me mendimin që me ndihmen e këtij shkollimi t'i bëjë ballë çdo sfide në jetë.

Shkolla duhet të jetë si një familje e madhe ku të gjithë nxënësit të promovohen një lloj.

Rinesa Çekaj

Guras

Këndi i poetëve



E lirë jam
Nuk mund ta shpreh
Gëzimin që kam
Tani shqiptoj mirë
Fjalë “e lirë jam”
Tanimë përfundoi
Robëria shekullore
Tash jetojmë të lirë
Në trojet arbërore
Në historinë shqipëtare
Ishin dy nëntorë
Kurse në historinë time
I treti është në këtë orë
Dëgjoni shokë e shoqe
Dy festa na gëzojnë

Dy festa na gëzojnë
Dy shtete shqipëtare
Një gjuhë dhe një komb
Sa lot derdhëm për atdhe
Dhe për të shtrenjtën liri
Ne jemi shtet i pavarrur
Të kemi paqe dhe barazi
Me 17 shkurt
Si një lule me vesë
Erdhi dita e pavarsisë
E bardhë atë mëngjes
Arritëm këtë ditë ne
Me shumë vuajtje e sakrifica
Por tash jemi të lumtur
Për të mirat që na i sjell dita

Tash në vendin tim
Po mbretëron liria
Tek çdo prag i derës
Lulëzon pavarësia
Tash di të gëzohem
Si të gjithë fëmijët e tjërë
Sepse shoh duke valvitur
Flamurin në erë
Tash jam e lumtur
Edhe shumë krenare
Për popullin tim
Për krenarinë arbërore

Jona Morina

Të vendos vet apo t`ia lë kohës



Koha shëron, apo shërohemini ne me kalimin e saj!?

Koha falë, apo falim ne me kalimin e saj!?

Koha është iluzion apo të them vegël e njeriut, koha nuk ndjen, nuk mendon e as nuk dashuron, e si mund të vendos koha pa ndjerë dashuri!?

Njeriu është qenje e nënvlërësuar, e nënvlërësuar nga vetvetja, ne nënvlërësojmë ndjenjat, dukurinë që udhëheqë jetën, që e shtynë e I jep kuptim asaj. Ne e nënvlërësojmë dashurinë, forcën që vë në harmoni çdo qelizë, çdo njeri e çdo ndjenjë, atë forcë që na sjellë në jetë. Nënvlërësojmë mendjen, Zotin e vetëm ekzistues, udhëheqësin e vërtetë e krijuesin e çdo gjëje mbi këtë tokë, shpikësin e këti fenomeni të quajtur “KOHË”. Aq shumë nënvlërësojmë sa që vendimet tona ia lëmë “KOHËS” ...

What traveling means to me



When I hear the word "travel" beautiful and different locations full of adventure come to my mind. However people travel for numerous reasons, which can vary from their personality and situation. I'm going to share what traveling means to me.

When I travel, I feel like I can go beyond my boundaries, pick up new hobbies and do things I never thought I would do like: skydiving, bungee jumping, feeding animals, voyaging the nature, pottery, meditation, photography etc.

Traveling is a new adventure every-day where new cultures are experienced and I can meet people who can teach me so much about truly living each day.

I especially enjoy communicating with natives they make me love their homes even more. True appreciation of a country's architecture comes when you know the stories of a nation's history. But it's not just the rich countries that are incredible, I love the places where people are rich at heart more. They make me forget about my little worries and I think why us who have so many material things are not full of bliss like them.

Traveling shapes our thoughts, it defines the things we thought we already knew, it teaches us what really matters. However we can also be a tourist in our own country by exploring new aspects of it and learning from our ancestors.

Hare Deçani

G u r a s

Këndi i poetëve të vegjel

KOSOVA

Me vite të tëra
Pavarësi kërkuam
Derisa një ditë e fituam.
Rrugën tone të gjatë
Me gjak e me lot,
E kemi mbuluar
Me festë e gëzim plot.
Historinë kujtojmë me shumë krenari
Do të ecim përpara
Me shtetin e ri.

Inara Bruçi, klasa III-1

KOSOVA

O Kosovë, o shteti im
Tí për mua je me vlerë
Si njëmanushaqe blu e verdhë
Lulëzon përhërë.
O Kosovë u bëre shtet
Shtet I vogël por me vlerë
Kur jam larg s'të harroj
Tërë kohën për ty mendoj.

Era Gashi ,klasa III-1

ESE

17 Shkurti Dita e Pavarësisë së Kosovës

Kosova pas shumë vuajtjeve nga ushtria serbe në vitin 1999 fitoj luftën kundër tyre.

Më 17 Shkurt 2008 Kosova u shpall Shtet i Pavarur. Pavarësia e Kosovës u shpall në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës prej 120 deputetëve pjesëmarrës ishin 109 deputet sepse serbët nuk morën pjesë. Sot në vendin tim gjithkund ka festë sepse festojmë 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Tani jetojmë të lirë! 10 vjet në liri.

Klesti Ukaj, klasa III-1

17 Shkurti –Pavarësia e Kosovës

Kosova festonë 10 vjet shtet,sepse është shpallur si shtet i pavarur. Ne ishim të pushtuar nga serbët,serbët na kanë mbyllur të gjitha shkollat. Adem Jashari luftoi sa mundi për të çliruar UÇK-në dhe Kosovën,sepse serbët ishin shkaktar sepse I lënduan njerëzit .Kur e ka ndëgjuar Evropa I kanë dërguar forcat luftarake të NATOS dhe kanë luftuar me serbët . Evropa iu tha kosovarëve tani jeni të lire.Kështu serbët jetuan në atdheun e tyre kurse ne në atdheun tone.

AURORA SOKOLAJ KL-II-të

G u r a s

Vizatime te nxënësve



Ilirian Ukaj


Dijona Selimaj



Axa Lekoshi

Zjana Hoxha

Jane Hoxha




Ilirian Ukaj



Erlina Gashi

G u r a s


Vizatime te nxënësve



Ujvesa Likaj



Leutrim Kadrijaj



© 2013. All rights reserved.
www.artspace.com
www.artspace.com



Euron Shala






Altin Dragaj

Altin Dragaj



Ema Ahmeti

Vizatime te nxënësve



G u r a s





